



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI**

Nr. 9058 prot.

Tiranë, më 3 . 10 . 2019

U D H Ë Z I M

Nr. 21 , datë 3 . 10 . 2019

PËR

**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
KUALIFIKIMIN, TRAJNIMIN DHE CERTIFIKIMIN E DREJTUESVE NË
DETYRË TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 48/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, gëzon ekskluzivitetin për administrimin e trajnimit e të certifikimit të detyrueshëm të drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar.
2. Kriteret dhe procedurat për kualifikimin, trajnimin dhe certifikimin, organizimin e programit të zhvillimit profesional dhe vlerësimi i pjesëmarrësve, hartohen nga Shkolla e Drejtorëve dhe miratohen nga bordi drejtues i Shkollës së Drejtorëve, në të cilin marrin pjesë dhe përfaqësuesit e MASR.
3. Trajnimi i drejtuesve në detyrë zhvillohet me kohë të pjesshme, pa shkëputje nga puna.
4. Grafiku i kryerjes së trajnimit të detyrueshëm përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e institucioneve arsimore parauniversitare të drejtuesve në detyrë, kohëzgjatja, procesi i trajnimit të vazhdueshëm e trajnimeve të tjera, si dhe procesi i provimit e certifikimit, hartohen nga Shkolla e Drejtorëve dhe

miratohen nga bordi drejtues i Shkollës së Drejtorëve, në të cilin marrin pjesë dhe përfaqësuesit e MASR.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletore Zyrtare”.

MINISTËR

Besa SHAHINI

